

20211221976

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NDAJ
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES FINANCIARE PËRGJIGJJA KOVID-19 E
MAQEDONISË SË VERIUT DHE E BZHMV-së, E PARAKAKTUAR PËR
FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE
NDËRMARRJEVE TË MESME TË KAPITALIZUARA TË TREGUT, QË DO TË LIDHET
MES BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE DHE BANKËS SË ZHVILLIMIT TË
MAQEDONISË SË VERIUT SHA SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton plotësimin e detyrimeve të marrëveshjes financiare Përgjigjja KOVID -19 e Maqedonisë së Veriut dhe e BZHMV-së për sigurimin e huas së financimit të ndërmarrjeve të vogla, të mesme, si dhe ndërmarrjeve të mesme të kapitalizuara të tregut në shumë prej 100.000.000 euro, e cila do të lidhet mes Bankës Europiane të Investimeve dhe Bankës së Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, Nëse Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut nuk i plotëson dhe servison detyrimet në afate dhe kushte të parapara sipas marrëveshjes financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me marrëveshjen financiare Përgjigjja KOVID-19 e Maqedonisë së Veriut dhe e BZHMV-së, që do të lidhet mes Bankës Europiane të Investimeve dhe Bankës së Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, për financimin e ndërmarrjeve të vogla, të mesme, si dhe ndërmarrjeve të mesme të kapitalizuara të tregut.

Neni 3

Të gjitha detyrimet të cilat burojnë nga marrëveshja financiare Përgjigjja KOVID-19 e Maqedonisë së Veriut dhe e BZHMV-së, sipas nenit 1 të këtij ligji, do t'i servisojë Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup.

Neni 4

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet në më së shumti 20 këste. Shuma minimale e këstit është 5.000.000 euro.

Për çdo tërheqje të shumës së huas në këste, Banka Europiane e Investimeve do të lëshojë Raport për tërheqje, në të cilin do të jenë përcaktuara kushtet përfundimtare financiare të këstit, ndër të cilat janë: shuma e këstit, data e shlyerjes, norma e interesit, afati i shlyerjes dhe kushtet e tjera për tërheqjen e mjeteve.

Afati i shlyerjes së çdo kësti të huas, përveç këstit për mjete qarkulluese, mund të jetë prej katër deri 12 vjet nga tërheqja e këstit, ku përfshihet edhe grejs periudha që mund të jetë mes 30 ditësh dhe katër vjetësh nga tërheqja e këstit. Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet për çdo këst veçmas në Raportin për tërheqje të këstit. Kësti mund të shlyhet një herë në ditë, që është mes tre dhe tetë vjetëve nga tërheqja e këstit.

Afati i shlyerjes së këstit për mjete qarkulluese mund të jetë katër deri pesë vjet nga tërheqja e këstit, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë mes 30 ditësh dhe një vjet nga tërheqja e këstit. Afati i shlyerjes së huas do të përcaktohet për çdo këst veçmas në Raportin për tërheqje të këstit. Kësti për mjete qarkulluese mund të shlyhet një herë në ditë, që është tre vjet nga tërheqja e këstit.

Neni 5

Norma e interesit për çdo kësht të huas do të përcaktohet veçmas në Raportin për tërheqjen e kështit.

Neni 6

Ministria e Financave dhe Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup do të lidhin marrëveshje të posaçme për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella të cilat burojnë nga marrëveshja financiare Përgjigjja KOVID-19 e Maqedonisë së Veriut dhe e BZHMV-së dhe Marrëveshja e Garancisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".